



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:290930

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05294199

**C.nr.2832/2021**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditësve O.Sh., R.Sh., S.M., B.M., B.E. dhe V.B. që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat A.A. nga Prizreni, kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i kualifikimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 8,397.60 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 07.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve O.Sh., R.Sh., S.M., B.M., B.E. dhe V.B. që të gjithë nga Prizreni, kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren.
- II. DETYROHET e paditura, që paditësve, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, tua paguaj:
  1. Paditësit O.Sh. nga Prizreni, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej 01.01.2019 e deri më 31.12.2020 apo për 24 muaj (për çdo muaj shumën prej 65.15 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 495.30 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,563.6 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
  2. Paditësit R.Sh. nga Prizreni, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej 01.01.2019 e deri më 31.12.2020 apo për 24 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 1,328.40 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
  3. Paditësit S.M. nga Prizreni, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej 01.01.2019 e deri më 31.12.2020 apo për 24 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej

1,328.40 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

4. Padi tëses B.M. nga Prizreni, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej 01.01.2019 e deri më 31.12.2020 apo për 24 muaj (për çdo muaj shumë prej 51.66 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 393.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumë prej 1,239.84 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
  5. Padi tëses B.E. nga Prizreni, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej 01.01.2019 e deri më 31.12.2020 apo për 24 muaj (për çdo muaj shumë prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumë prej 1,328.40 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
  6. Padi tësit V.B. nga Prizreni, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej 01.01.2019 e deri më 31.12.2020 apo për 24 muaj (për çdo muaj shumë prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumë prej 1,328.40 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadi së padi tësit O.Sh. përtej shumë së gjykuar sikur në pikën II. pika 1, deri në shumë e kërkuar prej 1755.60 euro, përkatësisht në shumë prej 192 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.
- IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadi së padi tëses B.M. përtej shumë së gjykuar sikur në pikën II. pika 4, deri në shumë e kërkuar prej 1755.60 euro, përkatësisht në shumë prej 88.56 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.
- V. DETYROHET e paditura, që padi tësve, t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 332 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Padi tësit O.Sh., R.Sh., S.M., B.M., B.E. dhe V.B. që të gjithë nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre Av. A.A. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me dt. 24.12.2021 kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i kualifikimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 8,397.60 euro.

Në padi, kanë theksuar se padi tësit janë në marrëdhënie pune në shkollën fillore "Mic Sokoli" në fshatin Lubi qevë, Komuna Prizren. Bazuar në Kontratën Kolektive të vitit 2017 padi tësit kanë plotësuar kushtet që në bazë të nenit 7 të kësaj Kontrate e paditura ka pasur obligim tua bëj

kompensimin mbi bazën e kualifikimit dhe licencimit. Me ç'rast kanë kërkuar kompensimin mbi bazën e kualifikimit nga data e hyrjes në fuqi e Kontratës Kolektive 17.04.2017 që e paditura Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, tua kompensoj 27 % të pagës bazë.

Me dt. 14.11.2023, paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë precizuar kërkesëpadinë ashtu që nga e paditura kanë kërkuar kompensim për periudhën kohore nga data 01.01.2019 e deri me dt. 31.12.2020 për 27% të pagës bazë 524.96 euro për paditësin O.Sh. në 24 muaj, për çdo muaj shumë prej 73.15 euro në muaj, ndërsa për paditësit O.Sh., R.Sh., S.M., B.M., B.E. dhe V.B. për periudhën kohore nga data 01.01.2019 e deri me dt. 31.12.2020 për 27% të pagës bazë 421.00 euro, për çdo muaj shumë prej 55.35 në muaj. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësve, të detyrohet e paditura t'ia kompensojë shumë e përgjithshme prej 8,397.60 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësit nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve duke deklaruar se paditësi ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, nga viti 2017 ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditësve. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit O.Sh., R.Sh., S.M., B.M., B.E. dhe V.B. që të gjithë nga Prizreni, janë në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës në shkollën fillore “ Mic Sokoli” në fshatin Lubiçevë, Komuna Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve iu takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësve për kompensimin

e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkuar.

Në këtë drejtim, gjykata përmes vërtetimit të dt. 30.01.2024, kontratës së punës e lidhur ndërmjet paditësit O.Sh., dhe të paditurës me nr të prot.54-4/17 e dt.22.09.2017, dhe kontrata e punës me nr.01-112-155822/01 i dt. 19.10.2018 u vërtetua se paditësi që nga dt.01.09.2017 e tutje është i punësuar në Institucionin Arsimor “Mic Sokoli” në fshatin Lubiçevë Komuna e Prizrenit ndërsa nga dt. 19.10.2018 ka pasur pozitën e drejtorit në po këtë shkollë. Nga diploma numër 1034 e dt. 11.07.2014 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Edukimit në Prishtinë- Qendra në Prizren si dhe licenca me numër 100022347 ka rezultuar se paditësi ka kualifikim shkollor Bachellor Kimi-Fizikë.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në koeficient 7.8 në shumë prej 495.30 dhe se paditësit në emër të kualifikimit në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 68.58 euro.

Nga vërtetimi i dt. 30.01.2024 dhe kontrata e punës e lidhur ndërmjet paditësit R.Sh. dhe të paditurës numër të prot.13 e dt. 19.10.2015, u vërtetua se paditësi që nga data 01.09.2015 është i punësuar në Institucionin Arsimor “Mic Sokoli” në fshatin Lubiçevë Komuna e Prizrenit. Nga diploma numër 73 e dt. 27.04.2011 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Edukimit në Prishtinë si dhe licenca me numër 100011882 ka rezultuar se paditësi ka kualifikim shkollor Bachellor i programit fillor.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421 dhe se paditësit në emër të kualifikimit në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Nga vërtetimi i dt. 30.01.2024 dhe kontrata e punës e lidhur ndërmjet paditësit S.M. dhe të paditurës me të prot.nr 24 e dt. 19.10.2015 u vërtetua se paditësi që nga data 01.09.2015 e tutje është i punësuar në Institucionin Arsimor “Mic Sokoli” në fshatin Lubiçevë Komuna e Prizrenit. Nga diploma numër 99 e dt. 20.08.2011 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Edukimit në Prishtinë si dhe licenca me numër 100011883 ka rezultuar se paditësi ka kualifikim shkollor Bachellor i programit fillor.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421 dhe se paditësit në emër të kualifikimit në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58,32 euro.

Nga kontrata e punës e lidhur ndërmjet paditëses B.M. dhe të paditurës numër të prot.20/2017 dt. 07.03.2017 dhe kontrata me numër të prot.16/18 e dt.27.02.2018 u vërtetua se paditësja që nga data 28.02.2017 e tutje është e punësuar në Institucionin Arsimor “Mic Sokoli” në fshatin Lubiçevë Komuna e Prizrenit. Nga diploma numër 2035 e dt. 18.03.2015 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti i Edukimit në Prishtinë si dhe licenca me numër ka rezultuar se paditësja ka kualifikim shkollor Bachellor i programit Para fillor.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 393 dhe se paditëses në emër të kualifikimit në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 54.45 euro.

Nga vërtetimi mbi përvojën e punës nr. 64/2021 i dt. 03.06.2021, kontrata e punës e lidhur ndërmjet paditëses B.E. dhe të paditurës me nr. prot. 78/18 e dt.21.09.2018 dhe kontrata e punës

nr. 86-2/19 e dt. 02.10.2019 u vërtetua se paditësja që nga data 10.04.2018 e tutje është e punësuar në Institucionin Arsimor “Mic Sokoli” në fshatin Lubiçevë Komuna e Prizrenit. Nga diploma numër 718 e dt. 08.01.2013 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit Qendra në Prizren ka rezultuar se paditësja ka kualifikim shkollor Bachelor Gjuhë dhe Letërsi Angleze.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421 dhe se paditëses në emër të kualifikimit në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58,32 euro.

Nga vërtetimi nr. 4/24 i dt. 30.01.2024, kontrata e punës e lidhur ndërmjet paditësit V.B. dhe të paditurës me nr. të prot. 99-14/16 e dt. 29.09.2016 u vërtetua se paditësi që nga data 01.09.2016 e tutje është i punësuar në Institucionin Arsimor “Mic Sokoli” në fshatin Lubiçevë Komuna e Prizrenit. Nga diploma numër 611 e dt. 06.04.2016 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit Qendra në Prizren si dhe licenca me numër 100011878 ka rezultuar se paditësi ka kualifikim shkollor Bachelor Fizikë-Kimi.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421 dhe se paditëses në emër të kualifikimit në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58,32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratat e punës, rezulton se e paditura, në emër të

kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve R.Sh., S.M., B.E., V.B. ia ka paguar shumën prej 58.32 euro, ndërsa paditësit O.Sh. i është paguar shuma prej 68.58 euro dhe paditëses Besartë Maçkaj i është paguar shuma prej 54.45 euro.

Sipas pikës 4 nën pikës 2 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit R.Sh., S.M., B.E., V.B. përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësit përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën II. nënpika 2, 3, 4, 5 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve, për çdo muaj t'ua paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur për 24 muaj nga data 01.01.2019 e deri me dt. 31.12.2020 në shkallë prej 27% të pagës bazë prej 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), secilit veç e veç shumën prej 1,328.40 euro.

Sa i përket paditësit O.Sh. gjykata gjeti se paditësi përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 133.73 euro, pasi që paga bazë e paditësit është 495.30 euro (koeficienti 7.8 i barasvlershëm me pagë 495.30 euro), gjë të cilën gjykata e ka vërtetuar nga lista e pagave sipas njoftimit të Ministrisë së Arsimit me numër protokolli 4540 i datës 11.12.2023. Andaj gjykata vendosi si në pikën II nën pika 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit, për çdo muaj t'ua paguaj shumën prej 65.15 euro apo diferencën e mbetur për 24 muaj nga data 01.01.2019 e deri me dt. 31.12.2020 në shkallë prej 27% të pagës bazë prej 495.30, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), shumën prej 1,563.6 euro.

Sa i përket paditëses B.M. gjykata gjeti se paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 106.11 euro, pasi që paga bazë e paditëses është 393 euro. Andaj gjykata vendosi si në pikën II nën pika 5 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses, për çdo muaj t'ua paguaj shumën prej 51.66 euro apo diferencën e mbetur për 24 muaj nga data 01.01.2019 e deri me dt. 31.12.2020 në shkallë prej 27% të pagës bazë prej 393, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), shumën prej 1,239.66 euro.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës për parashkrimin e kërkesës, mirëpo vlerësoi se sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësit padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar me dt. 16.12.2021, si dhe të njëjtën e kanë precizuar me dt.14.11.2023 dhe kërkesa e tyre është kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit për periudhën prej 01.01.2019 e deri me dt. 31.12.2020. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve nuk iu ka parashkruar kërkesa ngase paditësit e kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tyre në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë me dt. 24.12.2021.

Gjithashtu gjykata refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit sa i përket kërkesës së paditësit O.Sh. mbi shumën e aprovuar ngase nga vet provat e ofruara nga paditësi në padi -lista e pagave u vërtetua se paditësi realizon pagë bazë në koeficient 7.8 e barasvlershme në shumën prej 495.30 dhe se paditësit në emër të kualifikimit në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 68.58 euro, e që rrjedhimisht paditësit i takon kompensimi në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit në emër të pagës bazë (koeficient 7.8 e barasvlershme në shumën prej 495.30 euro) e jo të pagës bruto ashtu siç

është kërkuar me padi me pagën në shumë prej 524.96 euro për çdo muaj shuma prej 73.15euro, andaj edhe është refuzuar shuma prej 192 euro.

Gjithashtu gjykata refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadi së si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit sa i përket kërkesës së paditëses B.M. mbi shumën e aprovuar ngase nga vet provat e ofruara nga paditësja në padi -lista e pagave u vërtetua se paditësja realizon pagë bazë prej 393 euro dhe se e paditura në emër kualifikimit në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 54.45, rrjedhimisht kompensimi në emër të licencimit apo kualifikimit duhet ti llogaritet në pagën bazë dhe atë 393 euro, andaj edhe u refuzua shuma prej 88.56 euro.

Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadi së paditësit është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadi së, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadi a”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 312.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 332 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil  
C.nr.2832/2021 të datës 07.02.2024

Gjyqtarja

\_\_\_\_\_  
Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.